# Bashkia Berat

Monitorimi I zbatueshmerise se ligjit mbi barazine gjinore

FACT SHEET

2021

## SIPAS NUMRAVE

### ADMINISTRATA

| 33 % | 14 % | 33 % | 45 % | 43 % | 43% |
|---|---|---|---|---|---|
| Zv Kryetar/e | Administrator njesie | Administrata bashkise Bashkiake | Drejtor Drejtorie | Pergjegjes sektori Drejtorie | Drejtor Agjensie |

**Sigurohet** perfaqesim ne masen **mbi 30%** per secilen gjini

36 PROGRAMET BUXHETORE

Programet e Strehimit social




Bashkia NUK ka vendosur tregues gjinore dhe rrjedhimisht **NUK ka matje performance!**

**GRANTE PER BUJQESINE**




Aplikohet ne **vetem 1** nga 4 kategorite e programeve sociale.

Bashkia Berat ka vetem **56% pajtueshmeri ligjore** duke plotesuar 14 nga 25 detyrimet ligjore!

**100%** 9 nga 9

FUNKSIONET per te cilat Bashkia mbledh te dhena gjinore.

**STREHEZA PER GRATE E DHUNUARA**

Nuk ka nje strehez sociale, eshte ne faze ndertimi!

**GJETJE KRYESORE**

- ✓ Nuk ka info per programet e strehimit
- ✓ Bashkia KA një nëpunës vendor vetem për çështjet e barazisë gjinore
- ✓ Bashkia ka ngritur komisione per kryerjen e funksioneve te vecanta (60% gra)

ARRITJET

REKOMANDIME & AFATE KOHORE

Vleresimi per arritjet dhe rekomandimet do te jepet si Kryesi e Aleances!

Gjetje:

Arritje

1. Bashkia siguron respektimin në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrimit gjatë emërimit të punonjësve në Bashki.

2. Bashkia ka marrë masa konkrete për të promovuar barazinë gjinore dhe parandaluar diskriminimin me bazë gjinore, te tilla si:

- Buxheti gjinor
- Nisma gjinore për fuqizimin ekonomik:
- Grante për biznese të drejtuara nga gra kryefamiljare
- Promovimin e grave dhe vajzave për punët artizanale

3. Bashkia raporton që ka vendosur tregues gjinore, të cilën e manaxhon Drejtoria e Sherbimeve Sociale dhe Shendetesore.

4. Bashkia KA një koordinator për DhF, I cili edhe ka kërkuar urdhër mbrojtjeje për viktimat e dhunës në raste të caktuara. Koordinatori nuk punon me kohë të plotë.

5. Bashkia ka marrë masa konkrete bashkia për të promovuar barazinë gjinore dhe parandaluar diskriminimin me bazë gjinore, të tilla si:

- Fushata ndërgjegjësuese
- Trajnime/ Ëorkshop
- Hartimet e planeve / strategjisë në nivel lokal
- Marrëveshje bashkëpunimi

6. Bashkia ka databazën e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në territor për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, por nuk ka informacion nëse bashkëpunon me organizata jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore.

7. Bashkia ka ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit për rastet e dhunës në familje, si autoritet përgjegjës për manaxhimin e rasteve të dhunës.

8. Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare të internetit apo afishuar në vende të tjera publike, informacion të plotë e të kuptueshëm për programet sociale të strehimit për gratë kryefamiljare, vajzat nëna dhe viktimat e dhunës në familje.

9. Në programet e strehimit që financon bashkia ju jep përparësi grave dhe vajzave sipas kategorive:

- Subvencionimi I qerasë: 6 përfituese nga kategoritë: Gra, Gra kryefamiljare, Viktima të dhunës familjare, Vajza nëna

10. Bashkia ka raste diskriminimi për shkak të gjinisë të identifikuara nga administrata dhe asnjë masë nuk është marrë nga bashkia në këtë drejtim – psh bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, apo Komisioneri kundër Diskriminimit.

Sfida:

11. Nuk sigurohet perfaqesim ne masen mbi 30% per secilen gjini në pozicionin Administrator (7 pozicione – nje grua), nw maswn 14 %

12. Bashkia ka vendosur objektiva te ndjeshme gjinore vetëm në 2 nga 24 programe të buxhetuara. Duhet të vendosen objektiva të ndjeshme gjinore në të gjitha programet.

13. Bashkia nuk e di sa është raporti i shpenzimeve për politikat gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme dhe nuk e raporton këtë tregues, sipas Ligjit për "Financat vendore".

14. Bashkia nuk ka njësi performance.

15. Bashkia nuk strehëz si shërbim i kujdesit shoqëror për gratë, vajzat shtatzëna, prind i vetëm apo viktima të dhunës familjare; eshte ne fazw ndwrtimi.

16. Bashkia nuk ka skema vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim me të tretë, të krijuara/administruara nga bashkia

17. Bashkia mbledh statistika gjinore për 2 nga 9 funksionet, , por duhet të mbledhë për të gjitha funksionet në bazë të ligjit.

18. Bashkia nuk mbështet politika të zhvillimit të ndërmarrjeve sociale për gratë, gratë në zonat rurale, vajzat viktima të dhunës familjare;

29. Bashkia ka nëpunës vendor për çështjet e barazisë gjinore, por që mbulon edhe fusha të tjera.

23. Bashkia nuk mbështet politika të zhvillimit të ndërmarrjeve sociale për gratë, gratë në zonat rurale, vajzat viktima të dhunës familjare;

24. Bashkia nuk ka planifikuar në buxhet fonde vjetore për mbështetjen e realizimit të secilit program strehimi, bazuar në kërkesat e qytetarëve (ka vetëm subvencionim qeraje)